

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Për:</b>	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Artan Abrashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
<b>Cc:</b>	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
<b>Nga:</b>	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 10/01/2019 Nr.020-06
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit	
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim i Kuvendit të Komunës	


I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunale në vijim:

<b>Vendim Nr.001/011-183615 për zgjedhjen e Nënkyetarit për Komunitete të Komunës së Prizrenit</b>
<b>I miratuar më datë: 27/12/2018</b>
<b>I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04/01/2019</b>

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tilla mund të prodhojnë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za:	Mytaher Haskuka, gradonačelnik Opštine Prizren Artan Abrashi, predsedavajući Skupštine opštine Prizren	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinici za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>BF. Todosijević</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u, <i>Rozafa Ukimeraj</i>	
Od:	Venera Čerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS <i>Venera Čerkini</i>	Datum, 10.01.2019. Br.020-06
Premet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Prizren	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelniče,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:



Odluka br.001/011-183615 za izbor zamenika gradonačelnika za zajednice u opštini Prizren
Usvojena dana, 27.12.2018. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 01.01.2019.godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 12 paragrafa 2 tačka d), člana 61 paragrafa 2 i 3, Zakona za Lokalnu Samoupravu, br.03/L-040, člana 27 paragrafa 1, i člana 54 paragrafa 1 i 2 Statuta Opštine Prizren, br.01/011-5643, dana 15 oktobra 2008 godine, Skupština Opštine Prizren, na svojoj održanoj sednici dana 27 decembra 2018 godine, usvojila je ovu:

**ODLUKU  
ZA IZBOR PODPREDSEDNIKA ZA  
ZAJEDNICE OPŠTINE PRIZREN**

1. Za Podpredsednika za Zajednice imenuje se gđa Memnuna Ajdini.
2. Mandat Podpredsednika za Zajednice Opštine Prizren, biće isti kao Predsednika Opštine.
3. Plata za Podpredsednika za Zajednice Opštine, biće ista kao što je predviđena članom 4 par. 2, Administrativnog Uputstva Kancelarije Premijera Republike Kosova, za isplatu političkog osoblja u opštinama, 16/2008.
4. Ova Odluka, po potrebi može da se razmotri u svako vreme od strane Skupštine Opštine.  
Ovom Odlukom upoznati: izabranog podpredsednika, Direktorijat za Ekonomiju i Finansije i Arhivu.
5. Odluka stupa na snagu nakon slanja nadzornoj vlasti, shodno članu 81 Zakona za Lokalnu Samoupravu, br. 03/L-040, i objavljivanja na službenoj web stranici opštine.

**OPŠTINA PRIZREN**  
Skupština Opštine  
Br. 001/011-183615  
Dana: 27 decembar 2018  
Prizren





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Qeveria e Kosovës  
03.01.2019

001-011-183615 / 03.01.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS  
09.01.2019



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), nenit 61 paragrafit 2 dhe 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 27 paragrafit 1, dhe nenit 54 Paragrafit 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt.15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2018, miratoi këtë:

**VENDIM  
PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT PËR KOMUNITETE TË  
KOMUNËS SË PRIZRENIT**

1. Nënkyetar për Komunitete i Komunës së Prizrenit, emërohet znj. Memnuna Ajdini.
2. Mandati i Nënkyetarit për Komunitete i Komunës së Prizrenit, do të jetë i njëjtë sikurse i Kryetarit të Komunës.
3. Pagesa për Nënkyetarin për Komunitete të Komunës, do të jetë sikurse është paraparë me nenin 4 par. 2, të Udhëzimit Administrativ të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për pagesën e stafit politik në komuna, 16/2008.
4. Ky Vendim, sipas nevojës mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga Kuvendi i Komunës. Me këtë Vendim do të njohet: Nënkyetari i emëruar, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi.
5. Vendimi hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbyqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, dhe publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**KOMUNA E PRIZRENIT**  
Kuvendi i Komunës  
Nr. 001/011-183615  
Më: 27 dhjetor 2018  
Prizren

Kryesuesi i Kuvendit  
Artan Abrashi

## Sibel Gutiq

---

**From:** Jeton Qela  
**Sent:** Friday, January 11, 2019 2:20 PM  
**To:** Sibel Gutiq  
**Cc:** Rozafa Ukimeraj; Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Mimoza S. Morina  
**Subject:** RE: Konfirmimi i ligjshmërisë për vendimin për zgjedhjen e Nënkrëtarit për Komunitete KK- Prizren

Sibel,

Meqenëse kamë qenë në pushim vjetor, në ditën kur është mbajtur mbledhja e Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe atë ditë se kamë monitor mbledhjen, megjithatë unë para shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit, kam vërtetuar procesin e zgjedhjes së nënkryetarit përmes video-incizimit, dhe konstatoj se procedura ka qenë konform LVL-së. Në proces të zgjedhjes së nënkryetarit për komunitete kanë qenë të pranishëm 31 anëtarë të kuvendit. Nga 31 anëtar, 20 kanë votuar për, 11 kundër. Nga komunitetet KK-Prizren ka 7 anëtarë, ku nga 7 anëtarë 4 kanë qenë për, 3 nuk kanë marr pjesë në votim.

**From:** Sibel Gutiq  
**Sent:** Friday, January 11, 2019 11:30 AM  
**To:** Jeton Qela <jeton.qela@rks-gov.net>  
**Cc:** Rozafa Ukimeraj <Rozafa.Ukimeraj@rks-gov.net>; Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Mimoza S. Morina <mimoza.s.morina@rks-gov.net>  
**Subject:** Konfirmimi i ligjshmërisë për vendimin për zgjedhjen e Nënkrëtarit për Komunitete KK- Prizren

Përshëndetje Jeton,

Dje kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë për vendimin Nr. 001/011-183615 të Komunës së Prizrenit për zgjedhjen e Nënkrëtarit për Komunitete. Ju lutem a mund të na konfirmoni se a është verifikuar përqindja e komunitetit sipas censurit.

Faleminderit,  
Sibeli